



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-4634
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-6-
Data: Datum:	17, 06, 2025
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

EMRI I PSO: PAGESAT E KUJDESTARIVE DHE PAGAVE SIPAS KUSHTEVE TË KONTRATËS PËR SPECIALIZANTË

PËRMBAJTJA: PROCESI DHE PROCEDURAT E PAGESËS SË KUJDESTARIVE DHE PAGAVE TË SPECIALIZANTËVE, BAZUAR NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, DUKE PËRFSHIRË TË GJITHA HALLKAT E SISTEMIT TË PËRFSHIRA NË PROCES

VERSIONI: 1.1

DATA E APROVIMIT: 17/06/2025

AUTOR: MSh

NR. I HAPAVE/: III

NR. I NËNHAPAVE: 14

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretari Përgjithshëm, MSh



QËLLIMI	PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE PËR PAGESAT E PAGAVE DHE KUJDESTARIVE TË SPECIALIZANTËVE KA PËR QËLLIM TË RREGULLOJ PROCESIN DHE PROCEDURAT E PAGESËS SË KUJDESTARIVE DHE PAGAVE TË SPECIALIZANTËVE, BAZUAR NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, DUKE PËRFSHIRË TË GJITHA HALLKAT E SISTEMIT TË PËRFSHIRA NË PROCES.
NDËRLIDHJA ME AKTET	▪ LIGJI I PAGAVE Nr. 06/L-111; ▪ RREGULLORJA QRK 07/2023; ▪ UA 01/2023 'PËR SHKOLLIM SPECIALISTIK; ▪ VENDIMET E QEVERISË/MINISTRISË SË SHËNDETËSISË; ▪ VENDIMI I MINISTRI NR 29/16, DATË 15/03/2016) PËR PAGESËN E KUJDESTARIVE NË SPECIALIZIM.
LISTA E SHKURTESAVE	▪ BQSHS-BORDI QËNDROR PËR SHKOLLIM SPECIALISTIK; ▪ CPO-URDHËROBLIGIM PËR PAGESË; ▪ DAFSHP-DEPARTAMENTI PËR ADMINISTRATË, FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME; ▪ DZHSSH-DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM STRATEGJIK SHËNDETËSOR; ▪ MSH-MINISTRIA E SHËNDETËSISË; ▪ SHSKUK-SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS; ▪ ZKA-ZYRTAR KRYESOR ADMINISTRATIV; ▪ ZKF-ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
I	Verifikimi i statusit të specializantit	1. BQShS verifikon statusin aktual të specializantit, i cili sipas plan programit nuk e ka të paraparë mbajtjen e kujdestarive, sipas legjislacionit në fuqi; 2. BQShS verifikon statusin aktual të specializantit, i cili sipas plan programit e ka të paraparë mbajtjen e kujdestarive, sipas legjislacionit në fuqi.
II	Përgatitja e listave të kujdestarive nga mentorët klinik	1. ShSKUK përgatitë format/listat e unifikuara për regjistrim të kujdestarisë së specializantit, të veçantë për specializantin me vetëfinancim dhe atë të rregullt; 2. ShSKUK përgatitë listat e kujdestarive për secilin specializant, të nënshkruara nga mentori klinik dhe të verifikuara nga Drejtori i Klinikës, të cilat duhet të përmbajnë datën e saktë të mbajtjes së kujdestarive; 3. Mentori klinik obligohet të raportojë në Komitetin Specialistik përkatës në baza mujore, për specializantin i cili për arsye të ndryshme nuk i mban nga dy kujdestari në muaj, sipas plan programit, bazuar në legjislacionin aktual në fuqi; 4. Komiteti Specialistik i raporton BQShS për specializantin i cili nuk i mban nga dy kujdestari në muaj sipas plan programit, bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
III	Verifikimi i listave për pagesa të pagave dhe kujdestarive	1. Sekretaria e BQShS verifikon që emri i specializantit të përfshirë në listën përmbledhëse të pagesës së dërguar nga ShSKUK-ja, i takon kategorisë së specializantit; 2. Sekretaria e BQShS verifikon që në listë të pagesave të kujdestarive janë të përfshirë vetëm specializantët të cilët kanë kontratë valide; 3. Sekretaria e BQShS verifikon që në listë përfshihet vetëm specializanti i cili nuk ka kontratë tjetër pune; 4. Sekretaria e BQShS verifikon që lënda përmban dëshmi nga mentori klinik përkatës mbi kujdestaritë e mbajtura;

	5. Sekretaria e BQShS verifikon listat dhe përjashton mundësinë e përfshirjes njëkohësisht të specialistit të rregullt për pagesë përmes subvencioneve; 6. Sekretaria e BQShS verifikon që në listën e pagesave të kujdestarive janë përfshirë maksimum nga dy kujdestari; 7. Sekretaria e BQShS përgatit kërkesën për ekzekutim të pagesave për muajin gjegjës dhe e dërgon në DZhSSH për procedim të mëtejshëm, sipas procedurave ligjore në MSH; 8. Dosjes së përgatitur për ekzekutim të pagesës nga Sekretaria e BQShS, duhet t'i bashkëngjiten: — Formulari i kërkesës për mallra dhe shërbime; — Lista finale për pagesa; — Vendimi për pagesë të kujdestarive dhe pagave.
SQARIM	▪ Bazuar në UA 01/2023 për shkollim specialistik, neni 22 'Detyrat e specialistit', pika 1.5. 'Specializanti duhet të mbajë së paku 2 (dy) kujdestari gjatë muajit për plotësimin e planit programit të paraparë specialistik'. ▪ Bazuar në UA 01/2023 për shkollim specialistik Neni 21 "Të drejtat e Specialistit", pika 1.4 "Specializanti ka të drejtë të kompensohet për kujdestaritë e mbajtura në bazë të kontratës." ▪ Shtojca të kësaj PSO janë: 1. <i>Formulari për kujdestaritë e specialistëve të rregullt / MSh-99-KSR;</i> 2. <i>Formulari për kujdestaritë e specialistëve vullunter / MSh-101-KV.</i>

Shtojca Nr. 1: Formulari për kujdestaritë e specializantëve të rregullt / MSh-99-KSR;

[illegible]

Emri dhe mbiemri i Drejtorit të Klinikës

Nënshkrimi: _____

Shtojca Nr. 2: Formulari për kujdestaritë e specializantëve volunter / MSh-101-KV:

QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS
FORMULARI PËR KUJDESTARITË E SPECIALIZANTËVE ME VETËFINANCIM / MSH-101-KV

KOMITETI SPECIALISTIK:

MUAJI: _____

DATA: ____ / ____ / ____

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Specializantit	Nr. identifikues	Klinika	Nr. i Kujdes tarive	Datë	Shuma (Totali)	Emri dhe Mbiemri i Mentorit	Nënshkrimi i Mentorit	Data e mbarimit Shk. Spec.

Drejtori i Klinikës: _____